



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-CC-2019-07

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Data: 15 nëntor 2019

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim për caktimin e gjykatësve në një panel të Gjykatës
Kushtetuese**

Gjykatësve të panelit të Gjykatës Kushtetuese:

Gjykatës Vidar Stensland

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Antonio Balsamo

Mbrojtësit të z. Driton Lajçi:

Z. Tobi Kadman

Prokurorit të Specializuar:

Z. Xhek Smith

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në bazë të nenit 33(3) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), me anë të këtij vendimi, cakton panelin e Gjykatës Kushtetuese për të vendosur në lidhje me kërkesën referuese të z. Driton Lajçi (“Parashtruesi”), të datës 14 nëntor 2019.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 14 nëntor 2019, parashtruesi i paraqiti Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese kërkesë referuese publike me shtojca konfidenciale (“Kërkesa Referuese”).¹

II. CAKTIMI

2. Në përputhje me nenin 33(3) të Ligjit, caktohen tre gjykatës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese. Në rast pamundësie të kryerjes së detyrës prej njërit nga këta gjykatës, Kryetari cakton një gjykatës kushtetues rezervë.

3. Kryetarja merr parasysh dorëheqjen e gjykatëses An Pauër Ford më 14 nëntor 2019. Rrjedhimisht, Kryetarja cakton gjykatësin Antonio Balsamo në përbërjen e panelit të Gjykatës Kushtetuese.

4. Në përputhje me rregullën 4(2) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë, Kryetarja është siguruar se tre gjykatësit janë në dispozicion për kryerjen e detyrës.

¹ F00001, Kërkesë referuese Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me ligjshmërinë e procedurës së marrjes në pyetje, publike me shtojca konfidenciale, 14 nëntor 2019.

PËR ARSYET E LARTPËRMENDURA, NË VIJIM, KRYETARJA

cakton gjykatësit në përbërje të panelit të Gjykatës Kushtetuese për të vendosur në lidhje me Kërkesën Referuese, si më poshtë:

Gjykatës Vidar Stensland

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Antonio Balsamo

_____/nënshkrim/_____

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,
Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E premte, 15 nëntor 2019
Në Hagë, Holandë